



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.02.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, nr.501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatat e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, nr.504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:36 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)

5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Yllka Rupa*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Të tjerë: Vladimir Karaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, nr.501, datë 21.11.2022; si edhe në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, nr.504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 9 shkurt.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit kërkohet vendimmarrje sot për pesë çështje.

Kalojmë në çështjen e parë, nëse s’kemi diskutime mbi rendin e ditës.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurave të verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, nr.501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, nr.504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Kurushi për të relatuar aktin.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Pa humbur kohë, po filloj me relacionin që i bashkëngjitet projektvendimit përkatës me objekt “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, nr.501, datë 21.11.2022; si edhe në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, nr.504, datë 21.11.2022.

Në mbledhjen plenare të datës 21.11.2022, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 86, shkronja “ç” e ligjit nr.115/2016), me vendimet përkatëse të përmendura më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Afati i kandidimit për procedurën e ngritjes në detyrë si më lart u përcaktua deri më datë 05.12.2022.

Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej 18 (tetëmbëdhjetë) kandidatura (znj. {...} u tërhoq nga këto pozicione pas aplikimit për lëvizjen paralele, siç do të shfaqen në listën shoqëruese të këtij relacioni), të cilët kanë kandiduar në procedurën e ngritjes për pozicionet e lira në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”. Sipas këtij akti nënligjor, konkretisht Kreut V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c”, procedura e verifikimit të kandidatëve fillon me vendim të Këshillit, ndër të tjera, “jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit të gjyqtarëve për ngritjen në detyrë”. Këshilli, në këtë rast, duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet respektive të përmendura më lart nr. 499, 500 dhe 501, datë 21.11.2022.

ii. Mbi procedurën e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të zakonshëm për pozicionet e lira, në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në mbledhjen plenare të datës 21.11.2022, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor të përmendur më lart, me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr.504, datë 21.11.2022 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicione të lira në fushën e së drejtës penale.

Afati i kandidimit për procedurën e ngritjes në detyrë sa më sipër u përcaktua deri më datë 05.12.2022.

Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej 26 (njëzet e gjashtë) kandidatura, të cilët kanë kandiduar në procedurën e ngritjes për pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit

Tiranë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Korçë, në fushën e së drejtës penale të prezantuara si më sipër.

Përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore dhe konkretisht sa i përket ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në shkallët më të larta ose të specializuara, gjen rregullim edhe në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikërisht në nenin 48, ku në pikën 7 të kësaj dispozite, si dhe për ato në shkallët më të larta ose të specializuara, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit nr. 75, datë 23.05.2019.

iii. Mbi projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në: Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm të hapur sipas vendimeve si më lart të Këshillit, datë 21.11.2022 kandiduan gjithsej 32 (tridhjetë e dy) kandidatë (janë tërhequr nga këto kandidime znj. {...} dhe znj. {...}, ndërsa gjyqtarët e tjerë janë tërhequr nga disa pozicione të caktuara). Konkretisht, kandidatët që kanë kandiduar në 32 vende të shpallura me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë:

1. z. {...}; 2. z. {...}; 3. z. {...}; 4. znj. {...}; 5. znj. {...}; 6. z. {...}; 7. znj. {...}; 8. znj. {...}; 9. z. {...}; 10. z. {...}; 11. znj. {...}; 12. znj. {...}; 13. z. {...}; 14. z. {...}; 15. znj. {...}; 16. znj. {...}; 17. znj. {...}; 18. znj. {...}; 19. znj. {...}; 20. znj. {...}; 21. z. {...}; 22. znj. {...}; 23. z. {...}; 24. znj. {...}; 25. z. {...}; 26. znj. {...}; 27. znj. {...}; 28. znj. {...}; 29. znj. {...}; 30. znj. {...}; 31. z. {...}; 32. znj. {...}.

Referuar kandidaturave të paraqitura, rezulton se disa prej kandidatëve kanë kandiduar edhe më parë për ngritjen në detyrë në gjykatat më të larta (z. {...}, znj. {...},

znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}). Respektivisht, sa i përket kandidatëve që kanë kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë të hapura më parë, të dhënat aktuale për kandidimet e tyre janë si më poshtë:

1) Z. {...} për pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022.

2) Znj. {...} – ka kandiduar në kohë të ndryshme në total për 4 (katër) pozicione të lira, për të cilat është tërhequr nga kandidimi. Në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 174, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të cilin ka përfunduar procedura me vendimin nr. 539, datë 05.11.2020; Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, si dhe vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të cilët ka përfunduar procedura për shkak të tërheqjes nga kandidimi me vendimin nr.110, datë 25.03.2022; pra aktualisht nuk rezulton si kandidate në ndonjë pozicion të lirë, përveçse për pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022. Kualifikimi i kësaj kandidate është bërë nga Këshillit me vendimin nr.510, datë 21.11.2022.

3) Kandidatja znj. {...} – për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021 (Gjykata e Apelit Durrës, penale). Ndërkohë, kjo kandidate me shkresën e datës 16.12.2022 ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga konkurrimi në pozicionin vakant për ngritje në detyrë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, të shpallur me vendimin nr.503, datë 21.11.2022.

4) Kandidatja znj. {...} – për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 183, datë 28.05.2020 (Gjykata e Apelit Tiranë, civile); dhe pozicionin e shpallur me vendimin nr. 185, 28.05.2020 (Gjykata e Apelit Tiranë, seksioni penal).

5) Kandidatja {...} – ka kandiduar më parë për pozicione në gjykatën e apelit, për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 179, nr. 180 dhe nr. 182, datë 28.05.2020 procedura për të cilat ka përfunduar procesi.

Në pikën 6, të nenit 48, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “6. Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tre pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës”. Në konsideratë të këtij përcaktimi ligjor, në njoftimet publike të datës 08.12.2022, të interesuarve iu është bërë e ditur se:

“Këshilli i Lartë Gjyqësor bën me dije se disa nga kandidatët si më sipër, të cilët kanë kandiduar në më shumë se tre pozicione të lira në proces, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë ose dhe në gjykatat e apelit, do të njoftohen individualisht për të përcaktuar tre pozicionet për të cilët do të vijojnë kandidimin.”

Në respektim të përcaktimit ligjor si më lart, rezulton se vetëm disa prej kandidatëve kanë shprehur preferencat e tyre; ndërsa disa të tjerë kanë aplikuar për më shumë se 3 (tre) pozicione, konkretisht:

Zoti {...} rezulton të ketë kandiduar në 7 (shtatë) pozicione të lira, duke përfshirë atë të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022;

Në e-mail-in e datës 13.01.2023, ka njoftuar se: “Pozicionet ku do të vazhdojë kandidimin janë: 1) Për pozicionin në fushën e së drejtës penale në Gjykatën e Lartë, të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022. 2) Për pozicionin në fushën e së drejtës penale në Gjykatën e Apelit Korçë, të shpallur me vendimin 504, datë 21.11.2022; 3) Për pozicionin e lirë në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të shpallur me vendimin nr.500, datë 21.11.2022. Preferenca është sipas renditjes së cituar më lart.”

Zoti {...} për 6 (gjashtë) pozicione të lira. Me e-mail-in e datës 16.01.2023, njofton se: “Në përgjigje të e-mail-it tuaj për përcaktimin e 3 pozicioneve ku do të kandidoj për promovim në bazë të pikës 6 të nenit 48 të ligjit nr.96/2016 deklaroj se ato janë: 1. Gjykata e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, saktësuar me

e-mail-in pasues për pozicionin nr. 500 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; 2. Gjykata e Apelit Korçë. 3. Gjykata e Apelit Durrës.”

Zoti {...} për 6 (gjashtë) pozicione të lira. Me shkresën e datës 21.12.2022, ka bërë renditjen preferenciale për pozicionet: 1) të shpallur me vendimin nr.504, nr.502, nr. 503, datë 21.11.2022, duke hequr dorë nga kandidimi për pozicionet e tjera;

Zoti {...} për 4 (katër) pozicione të lira. Me e-mail-in e datës 17.01.2023, njofton se: “Heq dorë nga preferenca për vendin vakant në Gjykatën e Apelit Korçë.”

Më poshtë pasqyrohen kandidatët për çdo pozicion, pas rrethanave të reja të krijuara:

Për pozicionin lirë të shpallur me vendimin nr. 499, datë 21.11.2022, lista e kandidatëve është:

1) Znj. {...}; 2) Znj. {...}; 3) Znj. {...}; 4) Z. {...}; 5) Z. {...}.

Kanë hequr dorë zotërinjtë: Z. {...}; Z. {...}; Znj. {...}; Z. {...}; Znj. {...}; Z. {...}.

Për pozicionin lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, lista e kandidatëve është si më poshtë vijon:

1) Znj. {...}; 2) Z. {...}; 3) Z. {...}; 4) Z. {...}; 5) Znj. {...}; 6) Znj. {...}; 7) Z. {...}; 8) Znj. {...}; 9) Z. {...}.

Kanë hequr dorë nga ky pozicion përpara fillimit të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë kandidatët: Z. {...}; Znj. {...}; Z. {...}; Znj. {...}.

Për pozicionin lirë të shpallur me vendimin nr. 501, datë 21.11.2022, lista e kandidatëve është: 1) Znj. {...}; 2) Znj. {...}; 3) Z. {...}; 4) Z. {...}; 5) Znj. {...}; 6) Znj. {...}; 7) Znj. {...}; 8) Znj. {...}; 9) Z. {...}.

Kanë hequr dorë nga ky pozicion përpara fillimit të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore kandidatët si më poshtë: Z. {...}; Z. {...}; Znj. {...}; Z. {...}; Znj. {...}; Z. {...}.

Në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022, lista e kandidatëve është si më poshtë

vijon: 1) Znj. {...}; 2) Z. {...}; 3) Z. {...}; 4) Znj. {...}; 5) Z. {...}; 6) Znj. {...}; 7) Z. {...}; 8) Znj. {...}; 9) Znj. {...}; 10) Z. {...}; 11) Znj. {...}; 12) Znj. {...}; 13) Znj. {...}; 14) Znj. {...}; 15) Znj. {...}; 16) Z. {...}.

Kanë hequr dorë nga ky pozicion përpara fillimit të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë kandidatët e mëposhtëm: Znj. {...}; Znj. {...}; Znj. {...}; Z. {...}; Z. {...}.

Në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022, lista e kandidatëve është si më poshtë vijon: 1) Z. {...}; 2) Znj. {...}; 3) Znj. {...}; 4) Z. {...}; 5) Znj. {...}; 6) Z. {...}; 7) Znj. {...}; 8) Znj. {...}; 9) Z. {...}; 10) Znj. {...}; 11) Z. {...}; 12) Z. {...}.

Kanë hequr dorë nga ky pozicion përpara fillimit të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë kandidatët: Znj. {...}; Z. {...}; Z. {...}; Z. {...}; Znj. {...}; Znj. {...}.

Në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, lista e kandidatëve është si më poshtë vijon: 1) Znj. {...}; 2) Znj. {...}; 3) Znj. {...}; 4) Z. {...}; 5) Znj. {...}; 6) Z. {...}; 7) Znj. {...}; 8) Z. {...}; 9) Znj. {...}; 10) Znj. {...}; 11) Z. {...}.

Kanë hequr dorë nga ky pozicion përpara fillimit të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë kandidatët: Z. {...}; Z. {...}.

Lidhur me kandidimin e fundit të znj. {...}, ndërsa ajo ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, duke mbajtur në konsideratë faktin se kriteret ligjore të kandidimit janë të njëjtët me atë të kandidimit rishtazi të saj (këtu i referohem pozicionit të lirë të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 178, datë 11.05.2022), Komisioni vlerëson se një situatë e tillë ka gjetur rregullim të posaçëm në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të Këshillit nr. 75/2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, ku parashikohet ndër të tjera se: “Në rastin e

kandidatit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”.

Në kuptim dhe zbatim të këtij rregulli, për kandidaten znj. {...}, e cila ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, (duke qenë për pozicion të së njëjtës fushë të së drejtës), mbajtur në konsideratë faktin se kriteri ligjor i kandidimit, ai i pasurisë dhe figurës, është i njëjtë për çdo lloj kandidimi ngritjeje në detyrë, sa i përket kandidimit të saj rishtazi, procedura e verifikimit e përfunduar tashmë për atë sa i përket pasurisë dhe figurës, do të duhet të konsiderohet e vlefshme edhe për kandidimin e saj rishtazi, pra atë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Gjykatën e Apelit Durrës, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 503, datë 21.11.2022.

Gjithashtu edhe për z. {...}, në kushtet kur ka hequr dorë nga aplikimi i tij për pozicionin e lirë në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të shpallur me vendimin nr.500, datë 21.11.2022, verifikimi i pasurisë dhe figurës do të vijojë vetëm për pozicionin në gjykatën e apelit. Në këto rrethana edhe për këtë kandidat procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës që është aktualisht në proces për pozicionin e lirë të Gjykatës së Lartë të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022, vlen edhe për pozicionin e lirë në Gjykatën e Apelit Korçë të shpallur me vendimin nr.504, datë 21.11.2022 të Këshillit.

iv. Struktura e projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika. Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në: Gjykatën e Posaçme të shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorëve pas zhvillimit të procedurës së shortit për kandidatët e përmendur më lart (s’po i përmend edhe një herë).

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme: në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dhe në enën tjetër emrat e 30 (tridhjetë) kandidatëve të cilët kanë aplikuar për ngritjen në detyrë. Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për kandidatin përkatës të zgjedhur në vazhdim tjetër.

Komisioni propozon që secili prej anëtarëve të Komisionit të caktohet relator për 10 (dhjetë) kandidatë.

Pika 3 e projektvendimit bën fjalë për rregullimin e veçantë të situatës së verifikimit për kandidaten znj. {...} dhe kandidatin z.{...}, të cilët kanë kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, procedura e verifikimit për kriterin e pasurisë dhe figurës që ka përfunduar ose është në proces për këtë kandidim (për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 178/2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor), është e vlefshme edhe për kandidimin në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit për vëmendjen!

Bashkëlidhur është edhe lista përkatëse e kandidatëve për vendet e shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, kalojmë tek...

Brikena Ukperaj: Përpara se të kalojmë tek shorti.

Në kushtet kur tashmë me fillimin e funksionimit të hartës së re gjyqësore ne nuk kemi më gjykata të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, por është vetëm një gjykatë apeli e juridiksioni të përgjithshëm, marrë parasysh që në vendimin kuadër kemi përcaktuar që pozicionet që janë pozicione ngritjeje në detyrë apo ato që ne i kishim shpallur si pozicione ngritjeje në detyrë, do të konsiderohen si pozicione të Gjykatës së

Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, propozoj që edhe në (është më tepër për të saktësuar, jo ndryshim) titullin e projekt-aktit edhe në pikën e parë, edhe në pikën e tretë, të hiqen Gjykata e Apelit Durrës... sepse nuk janë më pozicione të këtyre gjykatave, por janë pozicione të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke korrigjuar edhe listën (meqenëse listat janë për pozicionet dhe nuk referohen në gjykata, por janë Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Apelit Korçë, Gjykata e Apelit Durrës). Janë pozicione të gjitha për efekt të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

(Saktësohet titulli, dhe pika 1 dhe 3 e projektvendimit sipas propozimit të bërë nga zonja Ukperaj. Ndërkohë përgatitet nga stafi mbështetës procedura e shortit.)

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek stafi për hedhjen e shortit.
(Ripërsëritet).

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Klodian Kurushi; z. Alban Toro dhe z. Dritan Hallunaj.

Futen në enën tjetër të qelqit shiritat e letrës me emrat e kandidatëve gjyqtarë: z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet emri i relatorit të parë. Përzgjidhet zoti Klodian Kurushi. Zoti Kurushi do të jetë relator për 10 kandidatët të cilët përzgjidhen nga shorti si më poshtë vijon:

12. {...}; 3. {...}; 1. {...}; 10. {...}; 2. {...}; 6. {...}; 21. {...}; 30. {...}; 7. {...}; 29. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të dytë. Përzgjidhet zoti Dritan Hallunaj. Zoti Hallunaj do të jetë relator për 10 kandidatët të cilët përzgjidhen nga shorti si më poshtë vijon:

9. {...}; 15. {...}; 22. {...}; 8. {...}; 4. {...}; 5. {...}; 24. {...}; 18. {...}; 17. {...}; 23. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të mbetur në enën e qelqit. Përzgjidhet zoti Alban Toro. Zoti Alban Toro do të jetë relator për 10 kandidatët të cilët përzgjidhen nga shorti si më poshtë vijon:

14. {...}; 27. {...}; 13. {...}; 19. {...}; 28. {...}; 16. {...}; 11. {...}; 20. {...}; 25. {...}; 26. {...}.

Naureda Llagami: Atëherë, jemi dakord me hedhjen e shortit?

Kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, nr.501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, nr.504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;

2. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;

3. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
4. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj;
5. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj;
6. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
7. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
8. Për kandidatin z. {...} - relator z. Dritan Hallunaj;
9. Për kandidatin z. {...} – relator z. Dritan Hallunaj;
10. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
11. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
12. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
13. Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro;
14. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
15. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj;
16. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
17. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj;
18. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj;
19. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
20. Për kandidatin z. {...} – relator z. Alban Toro;
21. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
22. Për kandidatin z. {...} – relator z. Dritan Hallunaj;
23. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Dritan Hallunaj;
24. Për kandidatin z. {...} – relator z. Dritan Hallunaj;
25. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
26. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
27. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
28. Për kandidaten znj. {...} – relator z. Alban Toro;
29. Për kandidatin z. {...} – relator z. Klodian Kurushi;
30. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Klodian Kurushi;
3. Për kandidaten znj. {...} dhe kandidatin z. {...}, të cilët kanë kandiduar më parë

për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022, procedura e verifikimit për kriterin e pasurisë dhe figurës që ka përfunduar ose është në proces për këtë kandidim, është e vlefshme edhe për kandidimin e tyre për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, 503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.02.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar dhe/ose për ndihmës ligjor, për vitin akademik 2023 – 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:36 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Yllka Rupa*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Të tjerë: Vladimir Karaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar dhe/ose për ndihmës ligjor, për vitin akademik 2023–2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt–aktin tjetër, i cili ka të bëjë me ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar dhe/ose për ndihmës ligjor, për vitin akademik 2023 – 2024.

Siç jeni në dijeni, kjo është një procedurë që Këshilli e zhvillon çdo vit në zbatim të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, është detyrim i Këshillit që të ngrejë Komisionin e Përkohshëm për verifikimin e këtyre kandidatëve që do hyjnë në provimin e pranimit në programin fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2023 – 2024.

Ajo që parashikohet në rregullore është që përbërja e Komisionit do të jetë nga dy anëtarë gjyqtarë dhe një anëtar jogjyqtar, të cilët zgjidhen pas zhvillimit të procedurës së shortit. Kryetari i Komisionit do të caktohet nga Kryetari i Këshillit.

Atëherë, në zbatim të rregullores, bëhemi gati për procedurën e shortit.

(Zonja Llagami propozon dhe hedh për votim mospërfshirjen në short të anëtareve, zonjat Marçela Shehu dhe Brikena Ukperaj. Anëtarët prezent në mbledhje janë dakord me këtë propozim. Nuk përfshihen në short dy anëtarët znj. Ukperaj dhe znj. Shehu.)

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e anëtarëve gjyqtarë: z. Dritan Hallunaj, znj. Irena Plaku, z. Klodian Kurushi, z. Ridvan Hado.

Futen në enën e dytë të qelqit shiritat e letrës me emrat e anëtarëve jogjyqtarë: z. Alban Toro, znj. Fatmira Luli, z. Ilir Rusi dhe znj. Yllka Rupa.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Emri i parë i përzgjedhur nga anëtarët gjyqtarë është z. Dritan Hallunaj.

Emri i dytë i përzgjedhur nga anëtarët gjyqtarë është z. Ridvan Hado.

Emri i tretë i përzgjedhur nga anëtarët jogjyqtar është z. Ilir Rusi.

Naureda Llagami: Atëherë, pas hedhjes së shortit, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar dhe/ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2023 – 2024 (në vijim Komisioni i Përkohshëm).

2. Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga tre anëtarë, 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar, të cilët zgjidhen pas zhvillimit të procedurës së shortit. Kryetari i Komisionit të Përkohshëm caktohet nga Kryetari i Këshillit.

3. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm, bazuar në pikën 2 të këtij vendimi është:

1. Zoti Dritan Hallunaj;

2. Zoti Ridvan Hado;

3. Zoti Ilir Rusi.

4. Komisioni i Përkohshëm merr masat për përmbushjen e detyrës së tij bazuar në procedurat dhe afatet e parashikuara në vendimin nr.424, datë 12.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.02.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:36 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Yllka Rupa*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Të tjerë: Vladimir Karaj (BIRN).*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, fjalën ia japim relatorit, z. Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Në kuadër të përpjekjeve që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka bërë për të plotësuar vendet vakante në të gjithë sistemin gjyqësor, ndër të tjera ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë edhe në Gjykatën Administrative të Apelit, edhe për një pozicion të lirë, me vendimin nr. 571 datë 07.12.2021.

Kandidatët që kanë marrë pjesë në këtë konkurrim, gjithsej kanë qenë 4: znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}. Gjatë procedurës së verifikimit, dy nga kandidatët u tërhoqën nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit ndërsa për dy kandidatët e tjerë që kishin kandiduar në procedura të tjera të hapura më pas për ngritjen në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, procedura e verifikimit për kriterin e pasurisë dhe figurës që ka përfunduar për këto kandidime, është bërë e vlefshme edhe për kandidimin e tyre për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë, më herët nga ana e Këshillit është realizuar procedura e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat të kriterëve të mëposhtme: përvoja profesionale, mospasja e masës disiplinore në fuqi, mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale, verifikimin e pasurisë dhe figurës, për të cilët janë marrë përkatësisht më parë vendimet përkatëse: për zotin {...} vendimi nr. 131, datë 06.04.2022, me anë të të cilit është vendosur kualifikimi dhe vijimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.571, datë 07.12.2021. Ndërsa, për zonjën {...}, kandidate për të cilën Këshilli, me vendimin nr. 542, datë 14.12.2022, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.571, datë 07.12.2021.

Ndërkohë, ka vijuar sistematikisht puna edhe për vlerësimin e tyre, 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, referuar pikës 5, të nenit 171, të ligjit “Për statusin”; 2) vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2019, referuar pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr.48/2019.

Në kuadër të përmbylljes së kësaj procedure, relatori ka administruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili do të mundësojë përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, sipas vendimit të Këshillit nr. 571, datë 07.12.2021.

Për kandidatin {...} u administruan dy vlerësime etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 196 dhe nr.197, datë 12.05.2021, vendime të cilët janë të formës së prerë, pasi nuk është aplikuar ankim ndaj tyre. Gjithashtu, edhe për kandidaten {...} u administruan edhe dy vlerësimet etike dhe profesionale përkatësisht me vendimet e Këshillit nr. 533 dhe nr.534, datë 17.11.2021, vendime të cilët janë përfundimtarë, të formës së prerë, pasi edhe për këtë nuk është depozituar ndonjë ankim në gjykatën respektive.

Për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të ligjit “Për statusin”, si dhe të detajuara në Seksionin B, Kreu IV, të vendimit 70/2020.

Referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua:

Për znj. {...} – Sipas vendimit të Këshillit nr. 533, datë 17.11.2021, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013–2016, në nivelin “Shkëlqyeshëm”; Sipas vendimit të Këshillit nr. 534, datë 17.11.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin “Shkëlqyeshëm”;

Për z. {...} - Sipas vendimit të Këshillit nr. 196, datë 12.05.2021, kandidati është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013–2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”;

Sipas vendimit të Këshillit nr. 197, datë 12.05.2021, kandidati është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që kandidatja znj. {...}, të ketë “Shkëlqyeshëm” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kurse z.

{...}, dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i ka “Shkëlqyeshëm” dhe “Shumë mirë”. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të ligjit “Për statusin”, identifikohet kandidatja znj. {...} si kandidate me rezultate më të larta.

Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 571, datë 07.11.2021, rezulton si më poshtë:

- 1) Znj. {...} ({...});
- 2) Z.{...}.

Edhe kandidatja e renditur më lart në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 571, datë 07.11.2021, pra znj. {...} ({...}), pavarësisht kandidimit edhe për pozicione të tjera të lira për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, konstatohet që, në momentin e kandidimit, të mos ketë shprehur preferenca kandidimi, sikurse përcaktohet në pikën 6, të nenit 48, të ligjit “Për statusin”. Për pasojë, për këtë kandidate është e pazbatueshme preferenca e kandidimit, duke u konsideruar njësoj e preferuar për të çdo kandidim i saj.

Në këtë kuadër është përgatitur drafti i vendimit, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...} ({...});
2. Z.{...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016, me ndryshimet përkatëse.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin, kalojmë në votimin e tij.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord. (*Vota e zotit Hado nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. Cit: "... Vote ime ka qenë Ridvani, dakord me propozimin". E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.*)

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...} ({...});
2. Z.{...};

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...} ({...}) dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 09.02.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:36 dhe mbaroi në orën 12:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Yllka Rupa**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Të tjerë: Vladimir Karaj (BIRN).**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek akti tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do të raportohet nga zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Pa humbur kohë po vijoj me relacionin e radhës që i bashkëlidhet edhe projektvendimi përkatës “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 20.01.2023, është depozituar një kërkesë me shkrim (protokolluar me aktin nr. 267, datë 20.01.2023) nga gjyqtari z. {...}, i cili aktualisht ushtron funksionin e gjyqtarit magjistrat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nëpërmjet të cilës ka vënë në dijeni, mbarimin e statusit të magjistratit, si shkak i mbushjes së moshës për pension pleqërie.

Zoti {...}, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë me vendimin nr. {...}, datë 08.05.1993, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa me vendimin nr. {...}, datë 06.07.1995, të po këtij Këshilli, është emëruar gjyqtar ushtarak në Gjykatën Ushtarake të Rrethit Gjyqësor Shkodër, detyrë të cilën rezulton se e ka ushtruar deri më datë 05.01.2009, dhe në vijim (pa ndërprerje) vazhdon të ushtrojë funksionin e magjistratit (gjyqtar) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Zoti {...} është i datëlindjes 05.02.1956; fillimi i detyrës 08.05.1993; vjetërsia në punë 29 vite; moshë e magjistratit aktualisht në momentin e hartimit të këtij relacioni ka qenë 66 vjeç e 11 muaj.

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64 të tij, parashikon kohëzgjatjen në detyrë të magjistratit. Një ndër rastet e mbarimit të statusit të magjistratit është edhe kur ai mbush moshën për pension. Konkretisht neni 64, pika 1 citojmë si më poshtë:

“1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen; b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji; ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën. ...”

Ndërsa në pikën 5 i po këtij neni, parashikohet se:

“5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur

ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaroi me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.”

II. Vlerësimi i Komisionit -

Kjo dispozitë ligjore, ngarkon Këshillin e Lartë Gjyqësor me përgjegjësinë për deklarimin me vendim, të mbarimit të statusit të magjistratit në rastin e plotësimit të kushteve të parashikuara në ligj për rastin e daljes në pension pleqërie.

Nga dokumentet e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, rezulton se z. {...} është i datëlindjes 05.02.1956. Për rrjedhojë ai mbush moshën për pension pleqërie 67 vjeç. Në rrethanat kur kërkesa për mbarimin e statusit, plotëson kushtet e parashikuara në pikën 1 dhe 5 të nenit 64 të ligjit “Për statusin”, është vendi që Këshilli i Lartë Gjyqësor të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.

Lidhur me efektet juridike, bazuar në pikën 5, të nenit 64, të ligjit “Për statusin” Këshilli deklaroi me vendimin mbarimin e statusit jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës. Muaji përkatës është muaji shkurt. Pra jo më vonë se në përfundim të muajit shkurt ne duhet të marrim vendimin që po marrim sot për deklarimin e përfundimit të statusit.

Në këtë rast, mosha për pension pleqërie arrihet 05.02.2023, e për rrjedhojë efektet e këtij vendimi parashikohen (sipas propozimit tonë) të fillojnë më datë 28.02.2023.

III. Struktura e projektvendimit -

Projektvendimi është i strukturuar në 4 pika. Në pikën e parë parashikohet deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.

Në pikën e dytë parashikohen efektet juridike, të cilat fillojnë më datë 28.02.2023.

Në pikën e tretë parashikohet komunikimi i këtij vendimi. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet

për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Në pikën vijuese parashikohet e drejta e ankimit kundër këtij vendimi. Ankimi mund të bëhet brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Së fundmi parashikohet dhe hyrja në fuqi dhe publikimi i tij. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, nëse nuk ka ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.

2. Efektet e vendimit fillojnë më datë 28.02.2023.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit,

në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Atëherë, me kaq i përfunduam çështjet. Çështja tjetër është çështje që zhvillohet me dyer të mbyllura.

Pas jam vënë në dijeni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për 1 orë duhet të mbledhemi për të caktuar gjyqtarë për gjykatat që janë në nevojë.

Faleminderit!

Shihemi më vonë.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor